REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____prot. Tiranë, më 22.6.2021

Lënda: Parashtrimet e Komisionerit Publik në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 22.6.2021, për aktet e administruara që i përkasin ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr.190, datë 26.7.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Ramiz Lala

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në seancën gjyqësore të datës 2.6.2021, bazuar në nenin F të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, në kuadër të shqyrtimit të çështjes objekt ankimi, trupi gjykues vendosi që, në kuadër të çeljes së hetimit gjyqësor, të kërkojë akte shtesë nga Gjykata Administrative e Apelit, dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër. Trupi gjykues vendosi, gjithashtu, t'i kërkojë Njësisë së Shërbimit Ligjor, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, kryerjen e analizës financiare për subjektin e rivlerësimit, për vitet 2011, 2014, 2015 dhe 2016.

Nga ana e Kolegjit, lidhur me praktikat e lartpërmendura, në datën 15.6.2021, me shkresën nr. ***/*** regj., janë përcjellë aktet si më poshtë:

A. Akte të sjella nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë (gjithsej 408 fletë), që i përkasin dosjes gjyqësore me palë paditëse ***. ***. dhe palë të paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, si dhe CD audio të procesverbaleve të seancave gjyqësore.

B. Akte të sjella nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër (gjithsej 39 fletë), që i përkasin dosjes gjyqësore me palë paditëse ***. ***. dhe palë të paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, si dhe CD audio të procesverbaleve të seancave gjyqësore.

C. Analizë paraprake ekonomiko-financiare, datë 14.6.2021, për vitet 2011, 2015, 2015 dhe 2016.

I. Komisioneri Publik, duke i analizuar këto akte në raport me secilin shkak ankimi, konstaton se:

1. *Lidhur me shkakun e ankimit që i përket çështjes gjyqësore me palë paditëse ***. ***. vs Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Person i interesuar shoqëria përmbarimore private "***" sh.p.k.*

1.1 Nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë janë përcjellë aktet nga dosja gjyqësore e vendimit nr. ***, datë ***.5.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Gjirokastër, me objekt (referuar padisë): "Shpalljen të paligjshëm dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit nr. ***, datë ***.1.2019, dhe rregullimin e pasojave juridike". Paditësi, gjatë ecurisë së procesit gjyqësor, ka saktësuar edhe objektin e padisë.

1.2 Nga konsultimi i akteve të dosjes gjyqësore të administruar nga ana e Kolegjit, rezulton se paditësi ka pasur disa çështje gjyqësore me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të cilat janë pjesë e saj, si në vijim.

1.3 Konkretisht, me urdhrin nr.***, datë ***.1.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është vendosur transferimi i z. ***. *** dhe emërimi në detyrë: Shef Sektori në Sektorin për Migracionin, në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin në Gjirokastër.

1.4 Urdhri i mësipërm është kundërshtuar nga paditësi gjyqësisht dhe subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, me vendimin nr. ***, datë ***.5.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Gjirokastër, ka vendosur: [...] (i) *Shfuqizimin e urdhrit nr. ***, të datës ***.1.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. (ii) Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit t'i njohë z. *** *** gradën policore Drejtues i Parë nga data ***.12.2007 e në vazhdim. (iii) Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit t'i paguajë z. *** *** pagën si Drejtues i Parë nga data ***.7.2008 e në vazhdim, deri në sistemimin e tij në detyrën që i takon sipas gradës policore Drejtues i Parë. (iv) Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit t'i njohë dhe paguajë z. *** *** sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe sigurimet suplementare dhe vjetërsinë në punë si Drejtues i Parë nga data ***.12.2007 e në vazhdim, deri në sistemimin e tij në detyrën që i takon sipas gradës policore Drejtues i Parë. (v) Vendimi i gjykatës të jepet në ekzekutim të përkohshëm dhe të menjëhershëm për të drejtat e përfituara nga subjekti nëpërmjet vendimit gjyqësor* [...].

1.5 Në çështjen gjyqësore me paditës ***. ***., palë të paditur Ministria e Rendit dhe person i tretë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë ***.12.2006, ka vendosur: *(i) Shpalljen si të pavlefshëm të urdhrit nr.***, datë ***.9.2006[1] dhe urdhrit nr.***/***, datë ***.9.2006,[2] të zv.ministrit të Punëve të Brendshme; (ii) detyrimin e të padituri të rivendosë të drejtat e cenuara në funksionin e mëparshëm si rezultat i pavlefshmërisë së akteve dhe (iii) detyrimin e të padituri të paguajë pagën prej 85.470 lekësh në muaj, që i përket gradës "Kryekomisar", [...]... duke filluar që nga data ***.9.2006 e në vazhdim [...].*

1.6 Në vijim, me vendimin nr. ***, datë ***.4.2008, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: *"Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj"*. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është bërë i ekzekutueshëm, pasi është lënë në fuqi nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë ***.4.2012, ka prishur

[1] Ulje në detyrë në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Formimit të Rolit Bazë në Qendrën e Studimeve të Kualifikimit në Akademinë e Policisë "Arben Zylyftari", në varësi të Ministrisë së Brendshme.

[2] I është caktuar grada "Nënkomisar", për shkak të mospërputhjes së gradës policore me funksionin organik, duke iu ulur paga mujore.

vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me ndryshimin: [...] *detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditësit pagën prej 85.470 lekësh në muaj, që i përket gradës "Kryekomisar", për një vit* [...].

1.7 Me vendimin nr. *** akti, datë ***.7.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit të vendimit nr.***, datë ***.12.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

1.8 *Vendimi gjyqësor është ekzekutuar për vlerën e 1 viti të pagës, që i përket gradës "Kryekomisar"*. Lidhur me mosekzekutimin e vendimit për pjesën e vendimit që ka disponuar kthimin e z. ***. ***. në punë, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. ***, datë ***.11.2015, ka konstatuar cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.***, datë ***.12.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për kthimin e gradës dhe ushtrimin e detyrës.

1.9 Me urdhrin nr. ***, datë ***.3.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është rikthyer në Policinë e Shtetit, në funksionin e Shefit të Sektorit, në Sektorin e Trajnimeve dhe Mjeteve Motorike, në Drejtorinë e Certifikimeve dhe Shërbimeve ndaj të Tretëve, në Akademinë e Sigurisë me gradën "Kryekomisar". Këtë urdhër, z. ***. ***. e ka kundërshtuar sërish në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, pasi e ka konsideruar si të nxjerrë në shkelje të hapur të ligjit, duke kërkuar njëkohësisht dhe nxjerrjen e të gjitha akteve që kanë të bëjnë me përfitimin e gradës dhe trajtimin financiar përkatës (pagë, vjetërsi, sigurime shoqërore etj.)

1.10 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin nr.***, datë ***.5.2018, ka vendosur: [...] *(i) Konstatimin e pavlefshmërisë së urdhrit nr. ***, datë ***.3.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; (ii) njohjen e detyrimit për zbatimin e vendimit të formës së prerë nr.***, datë ***.12.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke rrëzuar padinë për kërkimet e tjera* [...].

1.11 Me një tjetër padi, z. ***. ***., së bashku me shoqërinë private përmbarimore dhe të afërmit e tij (gruaja dhe fëmijët), në cilësinë e ndërhyrësit kryesor, i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt: shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror (moral), ardhur si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe konflikteve gjyqësore, dhe kallëzimeve penale mes palëve, në fazën e ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

1.12 Pas gjykimit të kësaj padie, rezulton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin nr. ***, datë ***.7.2018, ka vendosur: [...] *1. Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. 2. Detyrimin e palës së paditur, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Policisë së Shtetit, që, solidarisht, të paguajë në favor të paditësit, z.***. ***., dëmin jopasuror në vlerën 9.487.258 lekë. 3. Rrëzimin e kërkimit të paditësit, z. ***. ***., për shpërblimin e dëmit pasuror në masën 15.072.204 lekë, si të pabazuar në ligj dhe në prova. 4. Detyrimin e palës së paditur, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Policisë së Shtetit, që, solidarisht, të paguajë në favor të paditësit, Shoqëria Përmbarimore Gjyqësore Private "***" sh.p.k., dëmin jopasuror, në vlerën totale 11.321.891 lekë. 5. Pranimin e kërkesëpadisë së ndërhyrësve kryesorë. 6. Detyrimin e Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit, që, solidarisht, të paguajë në favor të ndërhyrësve kryesorë, ***. ***., bashkëshortja e paditësit dhe fëmijët e paditësit, dëmin jopasuror në vlerën 6.281.550 lekë* [...].

1.13 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e paraqitura në seancën e datës ***.6.2021, në lidhje me arsyetimin ligjor të këtij vendimi, ndër të tjera, shprehet se: [...] *Nëse unë do të ndryshoja standardin dhe arsyetimin tim ligjor nga njëri vendim në tjetrin, kjo do të ishte një provë që unë si gjyqtar nuk i marrë vendimet e mia si pasojë e një bindje time të brendshme, të bazuar në*

interpretimin e njëjtë që unë i bëj normës ligjore, por i marrë vendimet në varësi të interesit, cilësive dhe marrëveshjeve të palëve në proces [...].

1.14 Komisioneri Publik, referuar përmbajtjes së akteve të cituara më sipër, pa dhënë konsiderata lidhur me korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet, ashtu sikurse parashikohet nga neni 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, si dhe nga jurisprudenca e Kolegjit, konstaton se çështja objekt konflikti gjyqësor, për të cilën subjekti i rivlerësimit është shprehur me vendimin nr. ***, datë ***.5.2019, përveç pikës së parë mbi shfuqizimin e urdhrit nr.***/2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, për kërkimet e tjera rezultonte gjë e gjykuar.

1.15 Nisur nga aktet e administruara gjatë hetimit gjyqësor të këtij Kolegji, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, bazuar në aktet e administruara nga ai vetë, në fashikullin e gjykimit të çështjes në shkallë të parë, është njohur me vendimet e listuara më lart, duke administruar po ashtu edhe kërkimin e përfaqësuesit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit,[3] për rrëzimin e padisë, me pretendimin se po gjykohej një kërkim që përbënte "gjë të gjykuar".

1.16 Në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka shfaqur aftësitë për interpretimin e parimeve ligjore që rregullojnë institutin e sigurisë juridike, si dhe ka munguar të vlerësojë dhe analizën e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese në këtë aspekt[4].

1.17 Ndërkohë, lidhur me pretendimin e denoncimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, se vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit është dhënë në ekzekutim të menjëhershëm, pa pasur një kërkim të tillë nga pala paditëse, referuar akteve të administruara gjatë hetimit të urdhëruar nga ky trup gjykues, Komisioneri Publik konstaton se, në minutën 60 të materialit të CD: *"audio të procesverbaleve të seancave gjyqësore"*, përfaqësuesi ligjor i palës paditëse, z. ***.***., në bisedimet përfundimtare, ka kërkuar dhënien e vendimit në ekzekutim të menjëhershëm nga Gjykata.

1.18 Komisioneri Publik, bazuar në përmbajtjen e akteve të reja, të administruara gjatë hetimit, konstaton se, në referencë të nenit 72/2 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, duket se subjekti i rivlerësimit paraqet mangësi në drejtim të njohurive ligjore, garantimit të parimeve të pranuara të së drejtës, si dhe aftësisë për të analizuar jurisprudencën.

B. *Lidhur me shkakun e ankimit që i përket çështjes gjyqësore me palë paditëse ***. ***. dhe palë të paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit*

2. Nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Gjirokastër janë përcjellë aktet nga dosja gjyqësore e vendimit nr.***, datë ***.3.2017, me objekt (referuar padisë): "Detyrimin e palës së paditur t'i njohë paditësit gradën 'Drejtues' ".

2.1 Referuar akteve të kësaj dosje konstatohet se subjekti i rivlerësimit në këtë vendim gjyqësor ka analizuar se mosmarrëveshja objekt shqyrtimi ka lindur si pasojë e mosveprimit të palës së paditur, Drejtoria e Policisë së Shtetit, në hapjen e procedurave të konkurrimit për gradën policore "Drejtues". Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se, nga mosveprimi i palës së paditur në hapjen e procedurave të konkurrimit për gradën policore "Drejtues", paditësit i është mohuar një e drejtë e fituar me ligj, e drejta e mbajtjes së gradës sipas vjetërsisë dhe funksionit që kryen, dhe për këtë fakt, çështja objekt shqyrtimi gjyqësor bën pjesë në juridiksionin gjyqësor.

[3] Referohuni në dosje aktit: "Konkluzione përfundimtare", të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, datë ***.4.2019.
[4] Ndër të tjera, vendim nr. ***/2013, i Gjykatës Kushtetuese.

2.2 Nga përmbajtja e vendimit rezulton se subjekti i rivlerësimit, në përfundim të gjykimit, ka vendosur për dhënien e gradës policore "Drejtues", mbi bazën e kërkimit të palës paditëse, ***. ***., i cili ka pretenduar se ka vjetërsinë në Policinë e Shtetit, por pala e paditur nuk i ka krijuar kushtet për të marrë pjesë në një proces konkurrimi për të fituar gradën "Drejtues".

2.3 Subjekti i rivlerësimit, në parashtesën e depozituar në seancën e datës 2.6.2021, ndër të tjera, ka pretenduar se: [...] *Ankimi i Drejtorit të Përgjithshëm në lidhje me vendimin nr.***, datë ***.3.2017, dhënë në favor të z. ***. ***., është i pakuptimshëm, pasi vetë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi në Gjykatën e Apelit. Pra nuk ka pasur asnjë pretendim me ekzistencën e ndonjë paligjshmërie në vendimmarrjen time si gjyqtar* [...].

2.4 Në këtë pretendim të tij, subjekti i rivlerësimit i referohet jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, e cila ka arsyetuar se: […] *çmon të nevojshme për të rikonfirmuar qëndrimin se vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga një gjykatë më e lartë, e se asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë* […]. Për sa më lart, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se do të ndryshojë bindjen në lidhje me interpretimin e duhur të ligjit për çështjen në fjalë, vetëm kur do të ekzistojë një praktikë të unifikuar, e cila sipas tij mungon në rastin.

2.5 Komisioneri Publik vlerëson se, për shkak të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, institucionet e rivlerësimit, gjatë kryerjes së këtij procesi, kanë kompetenca kushtetuese dhe ligjore për të vlerësuar mbi aftësitë profesionale të subjekteve të rivlerësimit, edhe për çështjen konkrete.

2.6 Në raport me bindjen e brendshme të subjektit të rivlerësimit, referuar dhe vlerave themelore të magjistratit, të parashikuara në nenin 3, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, nënvizojmë se magjistrati ushtron funksionet në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, nga çdo palë dhe për çdo arsye. Në këto kushte, pa vlerësuar mbi korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, subjektet e rivlerësimit, edhe në rastin konkret, për shkak të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore të këtij procesi, lejohet të vlerësohen bazuar në indikatorët matës, të përcaktuar në nenet 72-76 të ligjit nr. 96/2016.

2.7 Duke iu referuar akteve të administruara nga ky trup gjykues gjatë hetimit, shtetasi ***. ***. i ka bashkëlidhur kërkesëpadisë këto akte: (i) Urdhrin nr. ***/***, datë ***.9.2015, për transferimin dhe emërimin në detyrë, përmes të cilit është emëruar Shef Komisariati në Komisariatin e Policisë Gjirokastër; (ii) Urdhrin nr. ***/***, datë ***.3.2015, "Për dhënie grade një punonjësi policie", përmes së cilit, në zbatim të vendimit nr. ***, datë ***.2.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Gjirokastër, i jepet grada policore "Kryekomisar"; (iii) Urdhrin nr. ***/***, datë ***.9.2015, "Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie", përmes së cilit, për nevoja pune, shtetasi ***. ***. transferohet dhe emërohet në detyrën Shef Komisariati në Gjirokastër; (iv) Kërkesë drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër, datë ***.2.2017, përmes së cilës ka kërkuar t'i krijohen kushtet për konkurrimin dhe fitimin e gradës "Drejtues", në zbatim të ligjit dhe VKM-së përkatëse; (v) Kthim përgjigje nr. *** prot., datë ***.2.2017, e Drejtorit të DVPGJ-së.

2.8 Ligji nr.108/2014, "Për policinë e Shtetit", në nenin 6, pika 3, parashikon se: […] "Gradë policore" është shprehje e hierarkisë policore, emërtimi i çdo shkalle dhe shenja dalluese, shprehje e cilësive individuale, eksperiencës dhe përgjegjësisë në ushtrimin e funksioneve në Policinë e Shtetit, *që fitohet nga punonjësi i policisë nëpërmjet një procesi konkurrues* […].

2.9 Për vetë specifikën e organit publik, ligji i lartpërmendur në nenin 50 të tij, "Sistemi i gradave", përcakton se: "2. *Sistemi i gradave, sipas këtij ligji, paraqitja, forma, emërtimet dhe mbajtja e tyre janë e drejtë vetëm e Policisë së Shtetit.* Ndërkohë, neni 53 përcakton se: *"Grada 'Nënkomisar' deri 'Drejtues i parë' jepet nga Drejtori i Policisë së Shtetit për punonjësit, të cilët e fitojnë atë nëpërmjet procesit të konkurrimit, sipas këtij ligji"*.

2.10 Në vijim, lidhur me procedurat e konkurrimit, neni 40 i ligjit parashikon se: *"Procedurat, rregullat e konkurrimit, transferimit brenda funksioneve të veçanta, si dhe funksionet e veçanta përcaktohen në Rregulloren e Policisë"*. Në rregulloren e Policisë, neni 161, "Kriteret për fitimin e gradës", parashikon se: "*5. Drejtori i Policisë së Shtetit, në varësi të nevojave dhe prioriteteve, miraton urdhrin për fillimin e fazës së aplikimeve për fitimin e gradës korresponduese, ku përcaktohen: a) numri i funksioneve të lira për gradën përkatëse; b) data e fillimit dhe mbarimit të procesit të aplikimit; c) Komisionet e Gradimit, Komisionet e hartimit të pyetjeve dhe mbikëqyrjes së procesit; ç) rregullat, procedurat dhe fazat e konkurrimit; d) Komisioni i Apelimit"*.

2.11 Nga aktet në dosje nuk konstatohet që Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, në zbatim të ligjit organik dhe akteve nënligjore përkatëse, të ketë organizuar një proces konkurrimi për dhënien e gradave, në të cilin të rezultonte se z. ***. ***. t'i jetë mohuar e drejta e konkurrimit nga organet administrative, në mënyrë që të pretendohej legjitimimi i gjykimit të ndonjë mosmarrëveshje nga juridiksioni gjyqësor.

2.12 Në këto kushte, duket se në vendimin nr. ***, datë ***.3.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Gjirokastër, mungon argumentimi i nevojshëm ligjor, në funksion të verifikimit indikatorëve të përcaktuar nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016, në pikat 1, 2 dhe 3 të tij, referuar cilësisë së analizës, njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor.

2.13 Në përfundim të analizës së akteve të administruara për këtë shkak ankimi, konstatohet se, për sa përmban dosja e vendimit gjyqësor nr.***, datë ***.3.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Gjirokastër, duket se identifikohen elemente që bëjnë të matshëm vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, në raport dhe me pretendimet në denoncimin e paraqitur nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

C. *Lidhur me kriterin e pasurisë*, mbi analizën paraprake ekonomiko-financiare për subjektin e rivlerësimit, z. Ramiz Lala, dhe personat e lidhur me të, për vitet 2011, 2014, 2015 dhe 2016

3. Nga analiza financiare e kryer nga Njësia Ligjore e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për vitet 2011 dhe 2014-2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë një mungesë të burimeve të ligjshme për mbulimin e investimeve, shpenzimeve dhe kursimeve në total, në shumën - 939.061 lekë.

3.1 Komisioneri Publik konstaton se kjo analizë financiare e paraqitur përmbush shkakun e ankimit për rivlerësimin e zërave financiarë, për vitet 2011 dhe 2014 - 2016, duke pranuar rezultatin e saj.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA